



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.734/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Gillogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Albena Reshitaj, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Suharekë paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.734/2021, i Albena Reshitaj, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Suharekë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për kandidaten për deputete të Kuvendit Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, në Vendvotimin: 2404A/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

IV. Kryesuesit të Vendvotimit 2404A/01R Ermal Zenelaj me nr. të letërnjoftimit 1244603293, si dhe anëtarëve të këtij vendvotimi Jehona Zenelaj me nr. të letërnjoftimit 1233996617, Jeton Kokallari me nr. të letërnjoftimit 1233123117, Ernad Gashi me nr. të letërnjoftimit 1171530004, Floriana Zenelaj me nr. të letërnjoftimit 1240762931, Glodiana Zenelaj me nr. të letërnjoftimit 1240763148, i ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 05.03.2021, nga Albena Reshitaj, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën sipas deklaratës së vëzhguesës Adelina Krasniqi, pretendon se në VV me numër 2404A/01R si kandidate për deputetet me numër 6 nga radhët e AAK-së ka pasur 31 vota kurse në

procesverbalet e publikuara në web faqe e KQZ-së i figurojnë 0 vota. Apelit ia ka bashkangjitur deklaratën dhe dokumentin e identifikimit të vëzhguesës Adelina Krasniqi si dhe kopjen e formularit të rezultatit të kandidatit për vendvotimin 2404A/01R.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.03.2021, të KQZ-së, ndër të tjera thekson se Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën Anr.734/2021, njoftoi se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve. Kur krahasohet me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota, por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura në QNR, nuk lejon asnjë Formular të kaloj, nëse nuk përputhet me votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota atëherë formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 05.03.2021, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutinë e vendvotimit 2404A/01R konstaton se pas numërimit të votave nga subjekti politik AAK, ka rezultuar se kandidati me numër 6 Albena Reshitaj i ka fituar 30 vota ndërsa 1 votë ka qenë e vlefshme vetëm për subjektin politik, sepse në fletëvotim kanë të rrethuar 6 kandidat e jo maksimum 5.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për deputet të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit dhe anëtarëve të vendvotimit të cilët janë nënshkruar në FRK, për pjesëmarrje në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kjo është marrë në bazë të nenit 120 par. 3, pika d) i LZP-së. Përgjegjësia e Kryesuesit rrjedh nga fakti se kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në

vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par. 10 të LZP-së, ndërsa përgjegjësia e anëtarëve që kanë nënshkruar FRK me shkeljet e evidentuara më lart rrjedh nga fakti i dhënies së pëlqimit me veprim konkludent, me vendosje të nënshkrimit. Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë dhe anëtarët kanë bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës nuk i janë paraqitur fletëvotimet në FRK ashtu si ishin në kutinë e votimit dhe kjo nënkuptohet si devijim i vullnetit të votuesve.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 734/2021 më datën 05.03.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

□